



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr.10
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10
Prishtinë, më 6 gusht 2021, në orën 9:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë : Fatmire Kollçaku, Haxhi Avdyli, Labinotë Demi- Murtezi , Mirsad Shkreta, Burim Karameta, Bekim Haxhiu, dhe Samra Ilijazi, anëtarë.

Munguan : Armend Zemaj, Miljana Nikoliq, Shemsedin Dreshaj dhe Uran Ismaili, anëtarë.

Stafi mbështetës: Shpresa Haxhijaj.

Pjesëmarrës të tjerë: Granit Bllaca, KDI, Violeta Salihu, KSH dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Procesi i monitorimit të ligjeve;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

3. Procesi i monitorimit të ligjeve

Fatmire Kollçaku, tha se Komisioni ka në procedurë të monitorimit dy ligje. Te monitorimi i Ligjit për shëndetin mendor, jemi drejt përfundimit të procesit monitorues. Ftoj kryesuesin e grupit monitorues të na informojë me në detaje për procesin.

Burim Karameta, tha se kemi zhvilluar takime të rëndësishme për monitorimin e këtij ligji dhe kemi mbledhur informata të rëndësishme. Në periudhën në vijim, do t'i diskutojmë edhe të gjeturat nga këto takime dhe vizita. Deri në fund të procesit monitorues, do t'i zhvillojmë edhe dy ose tri takime. Gjatë shtatorit, do t'i zhvillojmë edhe takimet e mbetura dhe do ta nxjerrim edhe raportin përfundimtar.

Fatmire Kollçaku, tha se tani të vazhdojmë me kryesuesin e grupit të monitorimit të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19, në territorin e Republikës së Kosovës.

Bekim Haxhiu, tha se monitorimi i këtij ligji është marrë me qëllim që të kemi sa më shumë informacione rreth zbatimit të këtij ligji, në mënyrë që kur ta kemi në amendamentim Ligjin për sëmundjet ngjitëse, të kemi sa më shumë informacione. Kemi zhvilluar disa takime dhe vizita, si në SHSKUK, IKSHP dhe vizitë në Qendrën e Vaksinimit salla „1 Tetori”. Në takimin që kemi pasur me drejtorin e IKSHP, specifikisht në disa kërkesa tona, drejtori ka kërkuar që t'ua dërgojmë me email, në mënyrë që ata të kenë kohë të na përgjigjen me të dhëna të sakta rreth testimeve dhe problemeve tjera me të cilat ata ballafaqohen. Bazuar në këtë kërkesë të drejtorit, si grup punues, e kemi dërguar një email, me kërkesa specifike për numrin e testeve PCR, të kryera në baza ditore në çdo komunë, numrin e testeve PCR në nivel vendi, pastaj edhe për testet me metodën RAT. Informacione për 1000 testet e pranuar si donacion nga Serbia, si do të menaxhohen, pasi nuk janë përdorur si dhe për numrin e punëtorëve të IKSHP-së, të cilët janë infektuar me COVID-19.

Pas këtij emaili të grupit punues, drejtuar IKSHP-së, kam pranuar një email të drejtuar nga kryetarja e Komisionit, e cila iu drejtohet institucioneve që të mos përgjigjen në emailin e mëhershëm të grupit punues, me arsyetimin që kërkesat janë shumë të përgjithësuara dhe grupi punues do t'ju adresojë disa kërkesa më specifike. Si kryesues i grupit punues, në emailin drejtuar IKSHP-së, kam bërë një kërkesë shumë specifike, me 7 pika. Kjo që ka bërë kryetarja e Komisionit është ndërhyrje në punën e deputetëve dhe të grupit punues. Nëse më është besuar ta udhëheq një grup punues, atëherë është e rëndësishme që të kemi sa më shumë informacione. Sipas Rregullores së Kuvendit, gjatë monitorimit të ligjit, ne mund të monitorojmë tërë punën e ministrisë që ndërlidhet me këtë ligj. Është absurde t'u dërgohet email institucioneve, për të mos ju përgjigjur deputetëve. Jemi të pakënaqur me menaxhimin e pandemisë, por kemi qenë të gatshëm t'ju ndihmojmë në këtë proces.

Bazuar në këto ndodhi, unë ju informoj se nuk mund të marr pjesë në një grup punues ku sabotohem nga kryetarja e Komisionit, prandaj tërhiqem nga kryesimi dhe nga ky grup punues, monitoroni vetë, pasi nuk doni t'i keni të gjitha informacionet.

Fatmire Kollçaku, tha se ju z. Haxhiu, si kryesues i grupit punues, e keni keqpërdorur pozitën, sepse nuk e keni diskutuar me kolegët e grupin punues këtë shkresë, ndërsa e keni adresuar në emër të grupit punues. Sikur ta kishit adresuar si deputet individual, atëherë nuk kishte pasur asnjë problem. Ju e dini që ligji është miratuar në fund të muajit gusht, të vitit të kaluar, ndërsa ju kërkonit informata që nga fillimi i pandemisë, pra keni dalë nga objekti i monitorimit të ligjit. Ligji monitorohet nga miratimi i ligjit, e jo më herët. Ne nuk jemi komision hetimor, por jemi në monitorim të zbatimit të ligjit. Të dhënat e të infektuarve në baza ditore janë të publikuar në ueb të Institutit të Shëndetit Publik. Doni të bëni një doktoraturë apo studim me kërkesat që i keni

parashtruar, ndërsa mjekët tanë të humbin kohën e tyre të çmuar, duke të përgatitur ty tabela në exell.

Ju deputet Haxhiu, jeni dyshues në çdo gjë dhe nuk i besoni as të dhënave zyrtare. Shkresën e kam dërguar që të tërhiqen kërkesat tuaja, pasi nuk kanë shkuar me informimin e grupit punues. Ju keni dalë jashtë kërkesave të monitorimit dhe informimit të grupit punues. Punën që e bëjmë ne duhet ta bëjmë këtu e jo përmes portaleve. Megjithatë, ju ftoj që punën ta vazhdoni në shtator, sepse nuk ju është cenuar asnjë e drejtë, por ju e keni keqpërdor të drejtën që ju është dhënë për kryesim. Çdo kërkesë që shkon në emër të grupit punues, duhet të diskutohet me anëtarët e grupit punues.

Bekim Haxhiu, tha se në takimin me drejtorin e IKSHP-së, kanë qenë prezentë të gjithë anëtarët e grupit punues dhe kërkesa ka qenë specifike për këto informacione. Kërkesa ishte që të raportojnë edhe institucionet private për testimet që i kanë bërë. Përgjigja juaj nuk është në pajtim me Rregulloren e Kuvendit. Për ne është me rëndësi zbatimi i ligjit, por është e rëndësishme t'i shohim edhe vështirësitë që i kanë pasur edhe para miratimit të këtij ligji. Raportimet e testeve bëhen të përgjithshme dhe nuk ndahen cilat janë për qëllime mjekësore e cilat për udhëtime. Qëllimi është të kemi informacione të rëndësishme për zbatimin e ligjit, e jo për hulumtime shkencore, sepse ato i bëj në fushën time të fizioterapisë.

Të gjithë keni qenë në takim kur unë i kam kërkuar këto të dhëna nga IKSHP dhe askush nuk keni kundërshtuar, pastaj kur kërkesa është bërë me shkrim, ju e keni kundërshtuar. Unë nuk i kam tejkalluar kompetencat fare, vetëm kam kërkuar informacion të rëndësishëm.

Labinota Demi– Murtezi, tha se pasi kam qenë pjesë e amendamentimit të këtij ligji, kam shprehur interesimin të jem pjesë e grupit punues dhe pasi deputeti Haxhiu ka qenë shumë aktiv në amendamentim të ligjit, i kam dhënë mbështetjen edhe të jetë kryesues i grupit. Por, të keqpërdorë këtë mbështetje dhe të shkruajë letra pa qenë të informuar si grup punues, kjo është ofenduese për ne. Qëllimi i monitorimit ka qenë që të kemi informata, duke pasuruar ligjin që është në proces të hartimit, pra Ligjin për sëmundjet ngjitëse. Grupi punues nuk ka punuar sa duhet dhe nuk ka qenë shumë aktiv dhe nuk duhet askush të bëjë kërkesa individuale.

Bekim Haxhiu, tha se deputetja Murtezi ka qenë prezent në takim me drejtorin e IKSHP-së dhe e ka dëgjuar kërkesën e drejtorit, që ka kërkuar që ne t'ia drejtojmë kërkesat me shkrim.

Labinota Demi – Murtezi, tha se kërkesat drejtuar IKSHP-së, kanë qenë gojore dhe të drejtpërdrejta.

Bekim Haxhiu, kërkesat për IKSHP-në kanë qenë nga takimi që kemi pasur në IKSHP. Kryetarja e Komisionit e ka minuar punën e grupit punues.

Haxhi Avdyli, tha se problemi ka mundur të zgjidhet shumë lehtë, ku deputeti Haxhiu, si kryesues i grupit punues, ka mundur ta mbledhë grupin punues dhe t'i diskutojë kërkesat që do t'i adresonte tek IKSHP. Të dhënat janë të publikuar në ueb të IKSHP-së, në baza ditore, ndërsa qëllimi i monitorimit ka qenë të shikohet zbatimi i Ligjit për pandeminë COVID- 19, e jo të hetohet menaxhimi i pandemisë. Mendoj se këtu kryesuesi pak e ka tejkalluar kompetencën e tij, edhe pse e çmoj për kontributin që ka dhënë në hartimin e këtij ligji.

Bekim Haxhiu, tha se për të kërkuar raportim për testet që kanë bërë në baza ditore nuk është hetim, por raportim. Pastaj të gjithë e dimë që disa komuna nuk kanë raportuar fare për testimet. Komunat, me ligj janë të obliguara të raportojnë në baza ditore për testimet e realizuara.

Fatmire Kollçaku, tha se për të qenë më të saktë, do ta lexoj shkresën drejtuar IKSHP-së: Numri i testeve RT-PCR të kryera në baza ditore për çdo komunë dhe numrin e përgjithshëm për tërë Republikën e Kosovës që nga fillimi i pandemisë COVID-19 deri më sot.

Numrin e testeve RT-PCR të kryera në baza ditore, të kryera nga institutet rajonale të shëndetësisë publike, prej kur kanë filluar deri më sot, si dhe testet e kryera në IKSHPK dhe SHSKUK.

Informacion i ndarë për raportimet ditore, numrin e testeve të kryera në institucionet private shëndetësore me metodën RT-PCR dhe RAT.

Informacion i ndarë për numrin ditor të testeve të kryera me metodën RAT, në institucionet publike shëndetësore.

Një raport për numrin e donacioneve të pranuar për testet RT-PCR dhe për aparaturën për testim.

Kërkojmë më shumë informacion për 1000 testet e pranuar donacion nga Serbia. Si rekomandoni të veproni me to, t'ia ktheni donatorit apo duhet të asgjësohen nga institucionet e Kosovës?

Sa është numri i punëtorëve shëndetësorë dhe jo-shëndetësorë të IKSHPK-së, në tërë Kosovën, të angazhuar gjatë pandemisë, sa ditë punë i kanë dhe sa ditë pushim i kanë pasur? Sa është numri i të infektuarve me COVID-19 në IKSHPK?

A keni qenë si grup punues për këto kërkesa dhe për mua këto kërkesa përfshijnë një punim shkencor.

Mirsad Shkreta, tha se ne jemi duke monitoruar zbatimin e ligjit që nga hyrja në fuqi e tij e deri më sot. Brenda kësaj periudhe mund t'i parashtrijmë edhe pyetjet dhe të bëjmë edhe kërkesa për informacion. Për pjesën tjetër jashtë ligjit për menaxhimin e pandemisë e inkurajoj deputetin Haxhiu të bëjë kërkesa dhe pyetje individuale ose të kërkojë komision hetimor apo çfarëdo që ai e sheh të nevojshme. Ne duhet ta vazhdojmë punën tonë brenda kompetencave të ligjit dhe me një konsensus të përbashkët.

Bekim Haxhiu, tha se kemi vendosur që ta monitorojmë këtë ligj, që t'i shohim vështirësitë që kanë ekzistuar para miratimit të ligjit dhe pas miratimit të ligjit, dhe për të pasur informacion për ta amendamentuar Ligjin për sëmundjet ngjitëse.

Në takimin me drejtorin e IKSHP-së, i kam parashtruar të njëjtat pyetje, të cilat janë të përfshira edhe në shkresën e drejtuar për IKSHP-në.

Mirsad Shkreta, tha se po në takim drejtori i IKSHP-së ka thënë se për kërkesa specifike mund të kërkon përgjigje me shkrim, por ky adresim me email, në emër të grupit punues, është dashur të jetë me pëlqimin e grupit punues apo së paku me njoftimin e grupit punues, për të cilën fare nuk kemi qenë të njoftuar.

Burim Karameta, tha se ne jemi grup punues dhe duhet të ketë bashkëpunim në mesë të tërë grupit dhe është gabim nëse jemi thirrur në çështje para miratimit të ligjit. Asnjë nga pikat e kërkuara në shkresë nuk të kish ndihmuar në vlerësimin e zbatimit të ligjit. E fundit, nuk e di pse ke kërkuar diçka ku në baza ditore janë publike. Pastaj, në asnjë nen të ligjit nuk shkruan se sa punëtorë duhet të jenë të angazhuar në menaxhimin e pandemisë që ti ke kërkuar numrin e mjekëve të angazhuar. Duhet të funksionojmë bashkërisht dhe të parashtrijmë kërkesa dhe pyetje që janë brenda mandatit tonë.

Bekim Haxhiu, tha se kam kontribuar shumë në hartimin e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19 në territorin e Republikës së Kosovës, prandaj tani në monitorim i shoh edhe mangësitë në zbatim. Raportim ditor që bëhen sot, bëhen në total. Disa prej komunave të Kosovës nuk i përgjigjen IKSHP-së. Të kërkojmë informacion se a po raportojnë të gjitha komunat

dhe a po raportojnë institucionet private shëndetësore, nuk mendoj që është bërë ndonjë gabim apo dëm. Por, t'i dërgohet email IKSHP-së nga kryetarja, për të mos u përgjigjur në kërkesat e mia, unë tërhiqem nga ky grup punues dhe nuk do të marr pjesë.

Fatmire Kollçaku, tha se detyrë e secilit deputet është për t'u kufizuar vetëm në procesin e monitorimit dhe konsultimin me grupin. Pra, e para është se ju keni dalë jashtë objektit të ligjit, dhe e dyta, ju keni tejkalluar kompetencat tuaja se nuk jeni konsultuar fare me grupin për shkresën e dërguar në IKSHP.

Bekim Haxhiu, tha se po ta përsëris që, asnjë tejkallim i kompetencës nuk ka ndodhur apo asnjë keqpërdorim i pozitës së kryesuesit të grupit punues. Informacioni për numrin e testeve të institucioneve private nuk e di pse është tejkallim i kompetencës, prandaj shkresa juaj është minim i punës së grupit punues, sepse në Rregulloren e punës së Kuvendit, neni 73, pika 3c, thotë që deputetët bëjnë kontroll të veprimtarisë së përgjithshme të ministrisë përkatëse.

Fatmire Kollçaku, tha se vendimi i deputetit për tërheqje nga grupi punues është vullnetar dhe ne nuk ndërhyjmë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20.

E përgatiti: Staf mbështetës i Komisionit.

Fatmire Kollçaku,

Kryetare e Komisionit